

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR

BENGU INDUSTRY SH.P.K

KREU I

Themelimi, Emri, Qëllimi, Kohëzgjatja, Selia, Website

Neni 1


Themelimi, Themeluesi, Emri, Objekti

(1) Sot më datë, 05.11.2023 (dymijë e njëzetë e tre), është krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin: BENGU INDUSTRY

(2) Themeluesi i shoqërisë është:

- a. Bujar Bengu, lindur në Posnovisht, ALB , më 01.09.1971 dhe banues në Belsh, MALAJ Nd 18 H 2 , në moshë madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me shtetësi shqiptare, e identifikuar me nr ID: H10901020I

I cili me vullnet të lirë e të plotë, mbështetur në Ligjin nr. 9901, datë 04.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, themelon këtë Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin: BENGU INDUSTRY



Neni 2 Forma Ligjore

(1) Shoqëria e përcaktuar në nenin 1 krijohet, në bazë të Ligjit Shqiptar nr. 9901, datë 04.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me mjetet në pronësi private të themeluesit të saj (më poshtë e quajtur “BENGU INDUSTRY”).

(2) Shoqëria është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortakët themelues”, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakëve përbën kapitalin e regjistruar të Shoqërisë.

Neni 3 Objekti i shoqërisë

Prodhim e përpunim materiale druri, alumini, plastike, pvc, xham, hekur etj. Të blejë apo te zotrojnë në ndonjë menyrë tjetër, të importojë, magazinojë, ruajë, të montojë, eksportojë apo tregtojë më shumicë e pakicë mallra të ndryshme. Të Importojë dhe të eksportojë mallrat e ndryshëm sipas nevojave të shoqërisë.


Neni 4 Selia, website dhe adresa elektronike, Pronësia Intelektuale

Selia e Shoqërisë së Projektit është në adresën: Elbasan, Belsh, Zona kadastrale nr 1839, ndertese private dy kateshe me nr pasurie 206/11. kati i pare .

Shoqëria e ushtron veprimtarinë e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Për kryerjen e kësaj veprimtarie ajo mund të hapë zyra, filiale, agjensi të përfaqësimit brenda vendit dhe jashtë tij në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe të vendit ku është hapur.

Shenjat dalluese të aktivitetit ekonomik, ndryshimet e adresave elektronike dhe website-it, nëse ka, do të njoftohen vullnetarisht në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Markat tregtare/patentat dhe pronësitë e tjera intelektuale të Shoqërisë do të regjistrohen/në përputhje me legjislacionin mbi pronësinë intelektuale.



Neni 5
Kohëzgjatja

- (1) BENGU INDUSTRY është person juridik shqiptar dhe fiton personalitet juridik që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në ligj.
- (2) Kohëzgjatja e Shoqërisë është e papërcaktuar.


KREU II
KAPITALI

Neni 6
Kapitali Themeltar

- (1) Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) lekë, e cila përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë, është i ndarë në 1(një) kuota.
- (2) Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 - a. Ortaku themelues Bujar Bengu, zotëruesi i 1 (një) kuote që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- (1) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/palujtshme apo të drejta).

Neni 7
Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

- (2) Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.
- (3) Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendimit të Asamblesë së Ortakëve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet QKB-së për regjistrim nga administratori, në përputhje me legjislacionin në fuqi.



Neni 8

Transferimi i Kapitalit

(1) Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a. Kontributit të kapitalin e shoqërisë
- b. Shitblerjes
- c. Trashëgimisë
- d. Dhurimit
- e. Cdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

(2) Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidarë ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga casti i kalimit të kuotave deri në castin e regjistrimit të kalimit të tij në Qendrën e Kombëtare të Biznesit.

(3) Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

(4) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE


Neni 9

Organi Vendimmarrës

(4) Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i Shoqërisë, që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e Shoqërisë.

(5) Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë në çështjet e mëposhtme:

- a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b. emërimin dhe shkarkimin e administratorit;



- c. emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve, audituesve ligjorë dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përcaktuar në pikat “b” dhe “c”;
- e. mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- h. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit.
- k. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjes së asamblesë
- l. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

(6) Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

(7) Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.

Neni 10

Mënyra e Thirrjes së Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

(1) Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

(2) Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsinë.



Neni 11 Kuorumi

- (1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 përqind të kuotave.
- (2) Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë një shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit për "Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë më shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- (3) Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 12 Marrja e vendimeve

- (1) Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- (2) Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:
 - a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b. emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
 - c. emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të audituesve ligjorë;
 - d. përcaktimin e shpërblimeve;
 - e. mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - f. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
 - g. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjes së asamblesë.



(3) Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 13

Përfashtimi nga e drejta e votës

(1) Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:

- a. vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d. dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

(2) Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku të cilin përfaqëson.

Neni 14

Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit është 5(pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

(2) Shoqëria BENGU INDUSTRY administrohet nga 1 (një) administrator.

(3) Asambleja e përgjithshme cakton si administrator të shoqërisë:

a. Mirel Bengu, lindur në Elbasan, më 08.11.1998 dhe banues Belsh, MALAJ Nd 18 H 2, në moshë madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me shtetësi shqiptare, i identifikuar me nr ID J811080111



Neni 15 Kompetencat e Administratorit

- (1) Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
- a. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e përgjithshme;
 - b. përfaqësojë shoqërinë tregtare;
 - c. kujdeset për mbajtjen saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d. përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e. krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f. kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”;
 - g. raporton përpara Asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe statut.
- (2) Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e përgjithshme në rastet kur:
- a. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
 - b. shoqëria, propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fund financiare të certifikuara;
 - c. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerën më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton nga pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- (3) Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson shoqërinë përpara të gjithë personave fizike e juridikë, publikë dhe/ose privatë vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshirë këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve, bankave të të gjitha niveleve etj.

(4) Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

(5) Nëse Asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

(6) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në cdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

(7) Administratori i Përgjithshëm ka të gjitha të drejtat dhe kompetencat që i njeh statuti dhe ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, Administratorit.

Neni 16

Përgjegjësitë e Administratorit

(1) Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj Shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Aktit të Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e përgjithshme, që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

(2) Përvec sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", administratori detyrohet:

a. të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të vecantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;

d. të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

e. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm

(3) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për cdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të

hetimit dhe vlerësimin të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

(4) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave (1) dhe (2) të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë cdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

(5) Në mënyrë të vecantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a. u kthen ortakëve kontributet;
- b. u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c. u shpërndan aktivet e shoqërisë;
- d. lejon që Shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare kur në bazë të gjendjes financiare duhet të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e. jep kredi.

(6) Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht osë së bashku kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit në faj.

(7) Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i Asamblesë së përgjithshme nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMIT

Neni 17

Viti Financiar Bilanci i Shoqërisë dhe Dividentët

- (1) Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përfundimisht viti I parë financiar fillon më ditën e regjistrimit të firmës në QKB dhe përfundon më 31 Dhjetor.
- (2) Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Përgjithshme, miraton bilancin e paraqitur nga Administratorët.
- (3) Asambleja e Përgjithshme vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëprashëm financiar, sic është parashikohet nga ligji.

Neni 18

Audituesit Ligjorë Detyrat dhe Përgjegjësitë

- (1) Audituesit ligjorë emërohen nga Asambleja e Përgjithshme.
- (2) Audituesit ligjorë mund të jenë persona fizik ose një shoqëri audituese.
- (3) Detyrat dhe përgjegjësitë:
 - a. Audituesit ligjorë garantojnë që llogaritë vjetore janë të rregullta e të hartuara me korrektësi e mirëbesim e sipas rregullave të etikës profesionale.
 - b. Japin një pasqyrim të plotë e real të rezultatit të operacioneve të vitit të kaluar financiar, si dhe gjendjes financiare e të trashëgimisë së shoqërisë në fund të këtij viti financiar.
 - c. Ata kanë për detyrë të përhershme, duke përjashtuar cdo ndërhyrje në administrim, të verifikojnë librat e llogarisë dhe fondet e shoqërisë si dhe të kontrollojnë përshtatjen e kontabilitetit të saj me legjislacionin në fuqi.
 - d. Ata verifikojnë gjithashtu korrektësinë dhe përputhjen me llogaritë vjetore të informacioneve të dhëna në raportin e administrimit përparë nga ana e Administratorëve për aksionerët mbi gjendjen financiare dhe llogaritë vjetore
 - e. Audituesit ligjorë sigurohen që është respektuar barazia ndërmjet ortakëve.

- f. Ai është i detyruar në cdo kohë, të bëjë kontrole në qendrën ose degët e shoqërisë, vetë ose nëpërmjet ndihmësve të tij dhe të mbledhë informacionet që i konsideron të nevojshme.
- g. Ka të drejtë të mbledhë informacione për shoqërinë nga shoqëri të tjera që bashkëpunon.
- h. Audituesi ligjor nuk mund të largohet nga shoqëria pa shkaqe të arsyeshme.
- i. Audituesi ligjor auditon llogaritë vjetore të shoqërisë konform ligjit Nr.10 091, datë 5.3.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” (ndryshuar me ligjin nr. 10 297, datë 8.7.2010, nr. 47/2016, datë 28.4.2016).
- j. Audituesi ligjor i bën të njohur Asamblesë së përgjithshme, dhe Administratorëve, kontrollat që ka kryer dhe verifikimet që ka bërë në pjesët e bilancit dhe dokumentave kontabël në të cilat duhet të bëhen ndryshime së bashku me vërejtjet përkatëse, parregullshmëritë dhe pasaktësitë e zbuluara si dhe përfundimet që rrjedhin nga vërejtjet dhe korrigjimet të krahasuara me rezultatet e vitit financiar të mëparshëm.
- k. Audituesi ligjorë është i detyruar të ruajë sekretet për të cilat vihet në dijeni gjatë ushtrimit të profesionit dhe është përgjegjës për dëmet që i shkakton shoqërisë nga veprimet apo mosveprimet me faj të tij.
- (4) Në përfundim të kontrollit, audituesi ligjor përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollat periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar t’ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t’i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 19

Të drejtat e Audituesit ligjorë

- (1) Audituesit ligjorë gëzojnë të drejtat e parashikuara në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar.
- (2) Nëse audituesit ligjorë nuk i kryejnë detyrat siç duhet, ata shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme.
- (3) Shërbimi i audituesve ligjorë përcaktohet nga Asambleja e përgjithshme me bazë mujore apo për cdo shërbim, parashikohet si shpenzim i vecantë dhe përballohet nga shoqëria.

Neni 20
Librat e Shoqërisë

- (1) Shoqëria duhet të mbajë librat e kërkuar nga ligji, në të cilët regjistrohen llogaritë vjetore, deklaratat financiare vjetore, bilancet vjetore, raportet ekonomike vjetore të cilët duhet të përmbajnë çdo gjë që parashikohet nga ligji.
- (2) Librat e shoqërisë si dhe pasqyrat financiare, bilancet vjetore dhe raportet financiare vjetore mbahen në gjuhën shqipe.

Neni 21
Të ardhurat neto

Të ardhurat neto (dividenti) që mbeten mbasi zbriten të gjitha detyrimet si dhe fondet e lëna rezervë për nxitjen ekonomike, për investime, për reklamën tregtare etj. Dhe të atyre për shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe ndahen nëpërmjet ortakëve në përputhje me përqindjen e pjesëve të kapitalit themeltar që ka secila palë si dhe të punës së secilit ortak në veprimtarinë e Shoqërisë.

KREU V
Prishja- riorganizimi i Shoqërisë

Neni 22
Prishja dhe Likuidimi

- (1) Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë:
- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b) me vendim të asamblesë së ortakëve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723m datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
 - e) me vendim të gjykatës.
- (2) Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një ose disa likuidatorë dhe shënuar në cdo dokument të nxjerrë prej tij, emrin e likuidatorit dhe emërtësën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.
- (3) Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

(4) Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.

Neni 23

(1) Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

(2) Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveç kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë vecmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkarisht të drejtat dhe detyrimet. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre për të kryer veprime të një kategorie të posacme. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundërdrejtohen të tretëve në përputhje me përcaktimet e ligjit.

(3) Likuiduesi i nënshtrohet mbikqyrjes së ortakëve dhe Administratorëve.

Neni 24

Të drejtat dhe detyrimet e Likuiduesit

(1) Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjithë veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kreditve të paarkëtuara dhe kontributeve të pashlyera, shitja e pasurisë së shoqërisë dhe shlyerka e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit sipas nenit 605 të K.C.

(2) Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të tjera tregtare për mbylljen e një veprimit të papërfunduar.

(3) Bëse në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit "Për tregarët dhe Shoqëritë tregtare", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen të pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

(4) Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në castin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në castin e mbylljes së procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit gjithashtu pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë me përgjegjësinë e kufizuar miratohen nga organi i vendimmarrjes, Asambleja e përgjithshme.

Neni 25
Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuidesi njofton Qendrën kombëtare të biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon cregjistrimin e shoqërisë në përputhje me ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”.

Neni 26
Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të mbledhjes së përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën IX të ligjit 9901, datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 27
Shndërrimi

Shoqëria mund të ndryshojë formën e vetë ligjore nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat dhe detyrimet që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

KREU VI
MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 28
Punësimi

Punësimi i punonjësve në Shoqëri bëhet mbi bazën e kontratës individuale të punës që lidhet midis palëve në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi I Punës I republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe të gjithë legjisllacionin Shqiptar në fuqi në lidhje me punësimin.



Neni 29

Marrja dhe Largimi nga puna

(1) Marrja në punë e personave të tjerë, jo ortakë të shoqërisë, bëhet me deklarin e tyre në Zyrën e Punës dhe pranë organeve të Sigurimeve Shoqërore si dhe me regjistrimin e tyre ne Regjistrin e të Punësuarve pranë shoqërisë.

2) Largimi nga puna ose ndryshimi I vendit të punës bëhet në bazë të një akti me shkrim të lëshuar nga administrator I shoqërisë. Largimi lidhet vetëm mbi bazën e një shkakut të arsyeshëm ligjor si mbarimi I afatit të kontratës së punës, ose kur konstatohetn shkelje disiplinore ose me vetë kërkesën e të interesuarit.

3) Largimi nga puna bëhet pasi të jetë shlyer të gjitha detyrimet material e monetare të individëve ndaj shoqërisë e anasjelltas.

Neni 30

Shoqëria merr përsipër të bëjë sigurimin e të punësuarve pranë saj në organet përkatëse duke derdhur rregullisht kontributet në përqindjet e caktuara sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 31

Marrëdhëniet me Bankat dhe Institutet Financiare

(1) Shoqëria ka të drejtë të celë llogari rrjedhëse, likujduese, depozita si dhe cdo lloj veprimi tjetër pranë një ose më shumë bankave ose instituteve financiare në shqipëri. Në këto banka apo institute financiare do të depozitohet nënshkrimi i administratorit për celjen e këtyre llogarive. Administratori duhet të nënshkruajë për të gjitha veprimet financiare në emër e për llogari të shoqërisë.

(2) Veprimet e Administratorit pranë këtyre bankave apo institucioneve financiare në lidhje me marrje kredie vënie peng, hipotekë etj do të kryhen mbi bazën e vendimit të Asamblesë së përgjithshme



KREU VII
TË NDRYSHME
Neni 32
Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi dhe Statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë Akt Themelimi dhe Statut do të zbatohet dispozitat e ligjit 9901, datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodi Civil e cfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 33
Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për cdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, apo edhe midis vetë ortakëve apo punonjësve të saj, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Tiranë.

Neni 34
Dispozita përfundimtare

Ky Akt Themelimi dhe Statut u hartua nga vetë ortaku në katër ekzemplarë me përmbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike në gjuhën Shqipe. Akt Themelimi dhe Statuti nënshkruhet prej ortakut pa asnjë rezervë.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

BENGU INDUSTRY

Bujar Bengu

